

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Cënuan perimetrin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/cenuan-perimetrin-e-sigurise-ne-shkolla-gjate-tubimit-te-djeshem-arresto-i586198
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:59:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 08:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f1541ea87a6874fabd4aaa56286ba2533f51af9067381d379f25e12d7a4a846d
TEKSTI	240968754986d4477dad720c98b622feccc650205c1e068677071a8c2d12449
PAMJA	7ad5e23e233a33d88f4b91c4e4fa807068a2c0fe53aa30d53f78d3c139e5aee5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80f721913f6d80e90c4b4eee4e645afd252ad0e6f0ec9f12d05fc49b5c141ec2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	908b1c27d6fb4398f588aae15509a84ac3468307df4d4ded5fae648af40858f1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80f721913f6d80e90c4b4eee4e645afd252ad0e6f0ec9f12d05fc49b5c141ec2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



15 Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerëNisi në Tiranë Konferenca e bioteknologjise "From Lab fundit

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë



15 Shtator 2026, 10:55Kronika TEMA



12 persona janë arrestuar në flagrancë dhe 15 të tjerë janë proceduar penalisht pas tubimit të zhvilluar më 14 shtator në Tiranë.

Sipas Policisë, pjesëmarrësit cënuan perimetrin e sigurisë së një shkolle, u bënë thirrje nxënësve për bojkotimin e mësimin dhe kundërshtuan punonjësit e Policisë.

Ngjarja nisi në sheshin "Skënderbej" dhe vijoi me marshimin drejt Rrugës së Durrësit, ndërsa ndaj të proceduarve janë ngritur akuza për disa vepra penale, përfshirë kundërshtimin e Policisë, mosbindjen ndaj urdhrave dhe organizimin e një grumbullimi të paligjshëm.

Njoftimi i policisë:

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkollë dhe kundërshtuan punonjësit e Policisë, gjatë tubimit të paligjshëm të zhvilluar dje, arrestohen në flagrancë 12 shtetas dhe procedohen penalisht 15 të tjerë.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në lidhje me tubimin e zhvilluar më datë 14.09.2026:

-u arrestuan në flagrancë shtetasit: E. K., 19 vjeç; D. B., 36 vjeç; A. D., 41 vjeç; E. B., 36 vjeç; R. D., 31 vjeç; B. I., 37 vjeç; V. D., 29 vjeç; A. M., 20 vjeç; A. A., 56 vjeç; R. K., 63 vjeç; K. B., 24 vjeç dhe E. Xh., 39 vjeç;

-u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit F. B., 32 vjeç; B. K., 27 vjeç; A. Zh., 26 vjeç; S. E., 32 vjeç; M. R., 28 vjeç; A. P., 49 vjeç; L. B., 39 vjeç; K. N., 20 vjeç; F. K., 34 vjeç; E. N., 33 vjeç, A. D., 23 vjeç, E. P., 31 vjeç, L. P., 26 vjeç, M. P., 18 vjeç, dhe I. M., 28 vjeç.

Më datë 14.09.2026, rreth orës 07:30, një grup personash u grumbulluan në sheshin "Skënderbej", për tubim, pa lejen përkatëse, dhe vijuan marshimin drejt Rrugës së Durrësit, ku ndaluan pranë një gjimnazi duke u bërë thirrje nxënësve për bojkotimin e procesit mësimor dhe pjesëmarrje në tubimin, duke cënuar perimetrin e sigurisë në shkollë.

Pavarësisht thirrjeve të punonjësve të Policisë për largimin nga perimetri i sigurisë në shkollë dhe për lirimin e trotuarit për kalimin e qytetarëve, disa prej pjesëmarrësve në tubim nuk iu bindën urdhrave dhe kundërshtuan me forcë punonjësit e Policisë, gjatë shoqërimit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “Kundërshtimi i punonjësit të Policisë së rendit publik”, “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të Policisë”, “Prishja e qetësisë publike” dhe “Shtytja e të miturve në krim”.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Himarë/ Ndezi disa vatra zjarri në kullota e pyje, kapet në flagrancë 52-vjeçari \(VIDEO\)](#)

10:35 Kronika

[Nga arratisjet spektakolare te dënimet me burgim të përjetshëm, si arriti Alket Rizai të merrte 16 leje për të dalë nga qelia](#)

10:05 Kronika

Dosja "Revanshi", GJKO jep vendimin për 7 të pandehurit, mes tyre Durim Bami

09:45 Kronika

[“Vendimi i KLGJ dhe KLP, i turpshëm” / Pagat e magjistratëve, Spaho: Vendosin Qeveria dhe Kuvendi!](#)

08:25 Kronika / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.